

ZERI I POPULLIT

ORGAN I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Viti 1 43-të i botimit
Nr. 88 (11.458)

E shtunë, 13 prill 1985

Çmimi 30 qindarka

Emri i shokut Enver do të rrojë përjetë i dashur, i nderuar dhe i respektuar në zemrat e gjithë komunistëve dhe të popullit tonë.

POPULLI YNE BEN HOMAZHE DHE NDERON ME RESPEKT E MIRENJOHJE TË THELLE SHOKUN ENVER HOXHA

— Udhëheqësit e Partisë dhe të shtetit bëjnë roje nderi pranë arkivolit me trupin e Udhëheqësit të dashur të Partisë e të popullit shokut Enver Hoxha —



Udhëheqësit e Partisë dhe të shtetit duke bërë roje nderi pranë arkivolit me trupin e shokut Enver Hoxha.

(Foto: ATSH)

Ditë e rëndë zie. Zemrat i pushtoi dhimbja e thellë për humbjen e madhe e të jashtëzakonshme të njeriut tonë më të dashur e më të shtrenjtë. Mjerisht është i vërtetë lajmi i pabesueshëm. Shoku Enver vdiq.

- Nuk na besohet!
- Tirana u gdhi me lotë.

Ora nuk ka shkuar ende shtatë dhe pranë selisë së Presidiumit të Kuvendit Popullor kanë ardhur mijëra veta. Duhet edhe dy orë gjersa të vejë ora 9.00, të hapen dyert e njerëzit të ecin kokulur, të përloitur duke shkuar për të bërë homazhe pranë arkivolit me trupin e shokut Enver.

Shëtitorja «Dëshmorët e Kombit» nuk ka asnjë zë që të dëgjohet. Secili pret, mendon në heshtje e gjithëkujt lotët nuk i mbahen. Ata që duan ta mbajnë më fort veten shtrëngojnë nofullat, përcjellin kombin e dhimbjes poshtë e kur loti i tradhton... e fshijnë fsheshtas! Duam të bisedojmë, por trishtimi i fytyrave të njerëzve na shtang. Secili është në botën e tij. I afrohem një veterani...

- Më linj djema! - flet ai me një zë të zvarrë, të dridhshëm dhe lotët i mbliqen te mjekra, - kjo është gjëmë!

Është dashuria e zjarrtë, e pakufishme për shokun Enver Hoxha, që flet kështu, është dhimbja e madhe. I jemi mirënjohës përjetë që na themeloi Partinë e na e kaliti atë, që ngriti në këmbë popullin e na çliroi vendin, që na begatoi një Shqipëri të re. E për çfarë nuk i jemi mirënjohës ne bashkëkohësit shokut Enver, këtij burri shteti të shquar, personaliteti i të cilit është në ato lartësi që qëndron e lavdishmja epepe e Luftës Nacionalçlirimtare, heroikja periudhë 40-vjeçare e ndërtimit socialist të vendit. Krenohemi ne për guximin e urtësinë e Tij, për mënjërinë dhe talentin e Tij prej udhëheqësi të shquar marksist-leninist. Koha jonë ka emrin e Partisë, ka emrin e Tij - Enver! Emrin e njeriut më të shquar, figurës më të ma-

dhe historike të popullit dhe kombit tonë.

- U mblohdëm të gjithë montorët, dje në orën 12.00, - na tregon Heroi i Punës Socialiste Njazi Ago. - Lajmi na tundi si një tërmet. S'e prisnim kurrë! Ako ma nuk na besohet. Ne po prisnim 1 Majin ta shihnim në tribunë të qeshur e të gëzuar si gjithmonë, të na shihte Ai duke brohoritur me gëzim të madh për Partinë. Dhimbje më e thellë nuk ka si bëhet!

Njaziu ka shtegtuar në 50-60 vepra industriale. E nisi me hidrocentralin «Lenin» dhe vazhdon...

- Gurin e themelit në çdo vepër e ka vënë Partia, shoku Enver, - vazhdoi heroi. - Sa na ka dashur ne punëtorët shoku Enver!

Qoftë edhe një bisedë e shkurtër të shpalos para syve peizazhet industriale të Atdheut, të sjell pranë fushat e begata e mallet e qëndisura nga dora e njerëzve punëtorë e trima. Ora ka shkuar 9.00.

Arkivoli me trupin e shokut Enver u vendos në sallën e Presidiumit të Kuvendit Popullor. Është vendosur mbi një piedestal të mëndafshët të kuq e pranë kurorat e panumërta. Në sfondin kryesor ndodhet një portret i madh në pikturë i shokut Enver dhe është shkruar 1908-1985. Mbi jashtëkë të kuq janë vendosur dekoratat e larta «Hero i Popullit», «Hero i Punës Socialiste» dhe urdhërat e shumta që Presidiumi i Kuvendit Popullor i ka akorduar shokut Enver Hoxha.

Rreth arkivolit bëjnë homazhe shoqja Nexhmije Hoxha, bashkëshortja dhe bashkëpunëtorja e shokut Enver Hoxha dhe pjesëtarët e familjes së tij. Janë momente sa prekëse aq edhe solemne. Shoqja Nexhmije Hoxha afrohet tek arkivoli, përulet, i ledhaton dorën e ia puth atë. Atë dorë që e ka shtrënguar një popull i tërë, që na ka rënë lehtë mbi supetë gjithëve. E puthin fëmijët, motrat, njerëzit e shtëpisë, të afërmit...

Me fytyrë të pikëlluara e sy të

përloitur hyjnë në sallë dhe bëjnë roje nderi pranë arkivolit me trupin e shokut Enver Hoxha shoku Ramiz Alia dhe shokët Adil Çarçani, Hajredin Çeliku, Hekuran Isai, Lenka Çuko, Manush Myftiu, Muho Asllani, Pali Miska, Rita Marko, Simon Stefani, Besnik

on të thellë arkivolin dhe përulen në shenjë respekti. Pastaj ata takohen dhe u shprehin ngushëllimet shoqë Nexhmije Hoxha, bashkëshorte dhe bashkëpunëtoe e shokut Enver Hoxha dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes. Bëjnë homazhe dhe roje nderi



Shoku Ramiz Alia i shpreh ngushëllimet shoqë Nexhmije Hoxha. (Foto: ATSH)

Bekteshi, Foto Çami, Llambi Gegprifti, Prokop Murra, Qirjako Mihali, Vangjel Çerrava, Haki Toska, Shefqet Peçi, Spiro Koleka, Xhafer Spahiu, Pilo Peristeri.

Udhëheqësit e Partisë e të shtetit nderojnë me grushtin lart kujtimin e paharruar të themeluesit e udhëheqësit të shquar të Partisë, prekin me dhimbje e emoci-

(Vijon në faqen 2)

RRON PARTIA, RRON SHQIPERIA SOCIALISTE, NDAJ RRON E DO TË RROJE NE SHEKUJ SHOKU ENVER HOXHA

— Nga letrat e telegramet e shumta dërguar Komitetit Qendror të Partisë —

I gjithë populli ynë, punëtorë, kooperativistë, ushtarakë, gra, të rinj e të reja, intelektualë, studentë e nxënës, i madh e i vogël shprehin dhimbjen e tyre të thellë për vdekjen e Udhëheqësit të lavdishëm të Partisë e të popullit tonë shokut Enver Hoxha. Në qindra e mijëra telegrame që i kanë ardhur e vazhdojnë t'i vinë KQ të Partisë, ata shprehin nderimin e madh për jetën dhe Veprën revolucionare të shokut Enver Hoxha, betimin e tyre solem për të ecur në rrugën e Partisë, në rrugën e socializmit, sipas mësimëve të shokut Enver Hoxha.

Në letrën e Plenumit të zgjeruar të Partisë për rrethin e Krujës, ndër të tjera, thuhet: «I premtojmë Partisë se te Vepra madhështore e shokut Enver, tek ide-të dhe mësimet e Tij, do të gjejmë gjithmonë forcën e pashtershme, frymëzimin, guximin dhe vetëmohimin për të vënë kudo, kurdoherë e mbi çdo gjë interesat e Partisë, të shtetit e të popullit, të revolucionit.

Në emër të klasës punëtoe, zotohem se gjatë 3-mujorit të dytë do të tejkalojmë çdo muaj 3 përqind planin e prodhimit të përgjithshëm industrial, 2 përqind vëllimin e ndërtimeve e të transportit, me qëllim që brenda 6-mujorit të mbyllim deficitet që na u krijuan gjatë muajve të pa-

rë të vitit nga vështirësitë e motit. Zotohem se do të bëjmë gjithçka për të realizuar detyrat që ka caktuar Partia që fusha e Krujës të marrë 50 kv grurë për ha, 70 kv misër për ha, 50 kv oriz për ha, 20 kv sojë për ha, 20 kv luledielli për ha në të gjithë sipërfaqen e mbjellë nën ujë». Komunistët dhe ndërtuesit e hidrocentralit «Enver Hoxha» të Komanit, ndër të tjera, shkruajnë: «Dora e ngrohtë e shokut Enver na ka shoqëruar në çdo hap ne, ndërtuesit e veprave të mëdha të dritës. Do të mobilizohemi më tepër se kurrë për ta ndërtuar sa më shpejt e me cilësi hidrocent-

(Vijon në faqen 2)

Trupi diplomatik vendosi një kurorë dhe bëri homazhe pranë arkivolit të shokut Enver Hoxha

Dje Trupi diplomatik i akredituar në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë vendosi një kurorë dhe bëri homazhe pranë arkivolit të Udhëheqësit të shquar të Partisë dhe të popullit shqiptar shokut Enver Hoxha në Selinë e Presidiumit të Kuvendit Popullor. (ATSH)

